



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr.763/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: Ntsh “AtomMed”-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: “Pharma Plus”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me aparat analajzer imunologjik automatik”, me nr. prokurimit: 70010-19-5667-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Spitali Regjional-Prizren, më datë: 27.11.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.HEDHET**, si e jashtë afatshme ankesa e operatorit ekonomik: Ntsh “AtomMed”-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me aparat analajzer imunologjik automatik”, me nr. prokurimit: 70010-19-5667-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Spitali Regjional-Prizren

**II. I LEJOHET**, Autoritetit Kontraktues Spitali Regjional-Prizren që të vazhdojë më tutje me procedurat e prokurimit me titull “Furnizim me aparat analajzer imunologjik automatik”, me nr. prokurimit: 70010-19-5667-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Spitali Regjional-Prizren, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër.

**III.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**IV.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: Ntsh “AtomMed”-Ferizaj, hedhet si e jashtë afatshme, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues: Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 29.10.2019, me nr. 763/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me aparat analajzer i munologjik automatik", me nr. prokurimit: 70010-19-5667-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Spitali Regjional-Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenet 18.10, 6, 8 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.11.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, në raportin e dt: 20.11.2019 sqaron si në vijim: Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti teknik sqaron se pretendimi i palës ankimore ka të bëjë me ofertën e operatorit ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës, përkatësisht potencohet se oferta e të njëjtit është oferte jo normalisht e ulet. AK, Spitali Rajonal i Prizrenit, përmes vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarim shtesë nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës, megjithatë nuk e ka aplikuar formulën siç parashihet me nenin 4 të rregullave për tenderët jo normalisht të ulet (legjislacion sekondar I nxjerrën nga KRPP), edhe pse sipas proces verbalit të hapjes shihet se oferta e të njëjtë operator ekonomik është dukshëm me e ulet se ofertat tjera të cilat kanë çmimin me të përafërt, rrjedhimisht këtë pretendim e kualifikojmë si të bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi tjetër ankimore ka të bëjë me kërkesat e specifikacioneve teknike të detyrueshme me pajisjen që ka ofertu ilOOOSR Abbot. Për të njëjtin pretendim eksperti teknik sqaron se AK, edhe përmes vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim ka sqaruar se në të njëjtën platformë (Analajzer) të jenë te



përfshira edhe testet tjera të ngjashme dhe me senzitive shumë të larte për diagnostifikimin e hershëm sëmundjeve kardilogjike dhe Infarktit akut të miokardit janë : Troponin T hs, Troponin i me Senzitivitet të larte; CK-MB, pro BNP, Mioglobina.

Marr nga specifikacioni i mësipërm: edhe teste tjera të ngjashme dhe me sensitivitet shumë larte Nuk është kërkuar me domosdoshmëri që platforma të përmbajë testet e lartcekura, por testet tjera të ngjashme dhe me senzitive shumë të larte për diagnostifikimin e hershem sëmundjeve kardilogjike dhe Infarktit akut të miokardit sic janë: Troponin T hs, Troponin me senzitivitet të lartë; CK-M8, progNP, Mioglobino, prandaj këtë pretendim ankimore e kualifikojmë si të pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.11. 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 27.11.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së si dhe eksperti teknik ndërsa eksperti shqyrtues mungon i njëjti është në përfaqësim të OSHP-së në Gjykatë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Poterqoi deklaroj: Ne si OE ankues pajtohemi pjesërisht në mendimin e Ekspertëve të angazhuar nga OSHP. Pajtohemi në atë se Çmimi i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është çmim jo normalisht i ulët sipas tabelës së parashikuar tek rregullat për çmime jo normalisht të ulëta, dhe AK ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së dhe Rregullores për çmime jo normalisht të ulëta. Këtë tabelë e kemi paraqitur në Ankesën tonë, por të cilën e kam edhe këtu me vete, të cilën mund të japë jap.

Me një analizë të thjeshtë mjafton të bëhet dhe të vërtetohen çmim jo normalisht i ultë të OE të rekomanduar për kontratë. Duke u bazuar në çmimin e ofruar nga të gjithë operatorët ekonomik dhe gjatë analizës së çmimeve vijmë në përfundim se “Pharmaplus” SH.P.K, ka ofertuar me çmim jo normalisht



prej 4,800.00€, kundrejt mesatares të të gjitha ofertave që është 14,375.00€. Shikuar nga kjo, rreth 300% është oferta më e ulët se mesatarja e të gjitha ofertave tjera.

Ky çmim ka ardhur si rezultat i asaj se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur specifikacionin teknik me pajisjen që ka ofertuar i1000SR Abbot. Kjo pajisje në mënyrën e saj që në kemi hulumtuar nuk posedon parametrin "Troponin T Hs ". Andaj, në nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues sa i përket specifikimit teknik se jo domosdoshmërisht platforma duhet të përmbajë të gjitha testet. Këtu eksperti teknik nuk e ka kuptuar qartë se termi testet tjera të ngjashme, nuk kanë për qëllim teste të zëvendësueshme, sepse secila ka rolin e vetë, por ka të bëjë me përfshirjen e këtyre testeve në panel kardiak apo menzura të testeve të zemrës që në kombinime me njëra tjetrën ato të mund të lexohen dhe të japin diagnozën e sakte.: (2) Troponin T hs , Troponin I me senzivitete të larta; CK-MB, proBNP, Mioglobina.

Njësia e kërkesës, Troponin T Hs, e ka vendosur si testet me TOP prioritet në menynë e 5 testeve në këtë pajisje, të cilën pajisja që e ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë nuk e posedon, përshkak se është pajisje demode dhe nuk është e avancuar dhe për atë edhe e ka çmimin 300% më të lirë.

Pajisja e ofruar është pajisje gjysmë dhe e cila do të vendoset vetëm në Depot e Spitalit ngase doktorët nuk do ta përdorin, nëse nuk e ka Troponin T Hs që është testi kryesor i cili bëhet në raste të ndonjë infarkti dhe diagnostifikon 95% të sulmit në zemër, dhe këtë e bënë menjëherë, dhe shumë më përpara se Troponin I, që diagnostifikimin e bënë vetëm pas 8 orëve. Por, nëse testet tjera kombinohen me troponin T Hs, japin një diagnozë akoma më të saktë siç janë: Troponin i me senzivitete të larta; CK-MB, proBNP, Mioglobina, ku janë vetëm mbështetëse të saj. Ku dihet se për një sulm kanë rëndësi sekondat e leje më orët, kjo për doktor ka rëndësi të madhe sepse për këtë kanë marrë edhe burg.

Kërkesa tjetër specifike të cilën duhet ta ketë pajisja është: Te këtë limit të lartë për leximin e Troponines në mënyrë që të shmangen hollimet dhe përsëritjet për mostrat me vlera shumë të larta.

Edhe kjo kërkesë dëshmon qartë për rëndësinë e Troponines T Hs në pajisjen analyser . LEXIM TE LARTE përkthehet HS apo High Sensitive që i përket Troponines T hS .

Me afatin në kemi paraqitur kërkesë me datën 01.10.2019 nuk ka njoftim nga Autoriteti Kontraktues nuk qëndrojnë ato me datën 08.10.2019 që thotë përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues, në vetëm kur e kemi par njoftimin e dhënies për kontratë dhe kemi bërë ankese në OSHP. Autoriteti Kontraktues nuk na ka kthyer asgjë, në kemi kërkuar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Ahmetaj deklaroj: Në fillimisht mendojmë që ankesa e OE ankues është e pas afatshme pasi janë kaluar të gjitha afatet kohore për parashtrimin e ankesës në OSHP, kanë kaluar 22 ditë pas kërkesë për rishqyrtim në Autoriteti Kontraktues. Në platformën



elektronike kemi pranuar dhe kemi dhënë përgjigje ne platforme, kemi prite 10 dite dhe gjegjësisht 22 dite kalendarike dhe kemi dhënë Kontratën. Me datën 08.10.2019 ju kemi përgjigjur për kërkesën për rishqyrtim dhe nga kjo dite kemi prite 22 dite kalendarike, ndërsa me datën 28.10.2019 është bërë njoftimi për shenjen e kontratës pasi nuk kemi pas asnjë kërkesë për rishqyrtim.

Me piken tjetër ne lidhje me spec. teknik ne si Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar edhe teste tjera te ngjashme nuk kemi kërkuar te jete Troponia High sensitiv. Ndërsa sa i përket pikës se 3-te me lidhje me tenderin jonormalisht te ulet, është e vërtet se OE i rekomanduar plotëson disa kritere te rregullores për kritere, por jo edhe refuzimin e kontratës, ne piken 4.1 cekte se nuk mund te refuzohet pa hetimin e disa gjerave, qe fillimisht ne si Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar përmes shkresës standarde për tenderët jonormalisht te ulet tek OE qe te jep edhe një sqarim sepse i plotëson te gjitha kushtet për tenderët jonormalisht te ulet, kemi bërë edhe kalkulimin e tabelës, OE i rekomanduar plotëson kriterin për tender jonormalish por nuk e plotëson kriterin nëse refuzohet kërkesa. Rregullorja për tenderët jo normalisht te ulet i përcakton 2 shembuj, neni 4 procedura Inter parters. Ne mendojmë se kemi bre ruajtjen e buxhetit dhe si përfundim kemi ardhur se ky tender duhet te jete i përgjegjshëm edhe pse ka çmimin jo normalisht te ulet.

Unë panelit i dorëzoj një kopje qe është print screen si dëshmi.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti teknik z. Fejza deklaroj: Ne me kujdes s e kemi shqyrtuar ankesën e OE ankues qëndrojmë mbrapa pretendimeve tona dhe kemi dhënë mendimin qe te kthehet lënda ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankues z. Poterqoi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe kërkojmë që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe OE i rekomanduar për kontrate te shpallet i pa përgjegjshëm dhe te zgjidhet një oferte e përgjegjshme.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Ahmetaj deklaroj: : Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe ankesa e OE ankues te shpallet e pas afatshme dhe e pa bazuar

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Autoriteti Kontraktues me datën 29.11.2019 përmes shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa Autoriteti Kontraktues me datën 30.11.2019 ka njoftuar OSHP se ankesa e OE është e Pasafatshme.



Paneli shqyrtues sqaron se Letra Standarde për tenderuesin e eliminuar është e datës: 26.09.2019.

Vendi i autoriteti kontraktues - AK-së, për dhënie të kontratës i dt.26.10.2019.

Operator ekonomik "Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, me datën:01.10.2019, ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim të vendimit të AK-së.

Autoriteti kontraktues me dt. 08.10.2019, i ka kthyer përgjigje OE ankues në kërkesën e tij për Rishqyrtim te datës:01.10.2019.( bazuar në dëshmitë e gjatuara në E-prokurim).

Operatori ekonomik OE " Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, me dt. 29.10.2019, ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 763/19, duke pretenduar se nuk është njoftuar fare nga AK me vendim për kërkesën për rishqyrtim duke ia bashkangjitur ankesës së tij një vendim të AK-së te dt.10.08.2019.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lendes, sqarimeve të marra nga E-prokurimi KRPP, konstaton se OE Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, ankesën në OSHP e ka dorëzuar në ditën e 21-të. Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes sistemit të E-prokurimit me dt. 08.10.2019, e ka njoftuar OE ankues me vendimin e tij për kërkesën për rishqyrtim të OE ankues te dt. 01.10.2019, pra autoriteti kontraktues i është përgjigjur kërkesës për rishqyrtim OE ankues me vendim të cilin vendim AK e ka ngarkuar në platformën e E- prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se dt.10.08.2019, që gjendet në vendimin për refuzim të kërkesës për Rishqyrtim të OE Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, mund të jetë ndonjë gabim teknik sepse dëshmitë që OSHP-ja, i ka siguruar nga E-prokurimit – KRPP, dëshmojnë se AK përmes platformës elektronike i është përgjigjur kërkesës për rishqyrtim te OE ankues me dt. 08.10.2019, ora 11:26:41s.

Paneli shqyrtues konstaton se OE Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, ankesën e në OSHP e ka parashtruar jashtë afatit ligjor dhe se e njëjta nuk mund të shqyrtohet nga ana e Paneli shqyrtues.

Paneli shqyrtues konstaton se ankesa e OE Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, e dt.29.10.2019 me nr. te protokollit 763/19, është parashtruar në kundërshtim me nenin 109 të LPP-së dhe nenin 9 Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.

Paneli shqyrtues sqaron se neni 109 i LPP- së specifikohen afatet ligjore për parashtrim të ankesës , ku në nenin e lartcekur thuhet : Afatet për Dorëzimin e Ankesës - Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për

zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Paneli shqyrtues sqaron se afati i fundit për parashtrim të ankesës në OSHP lidhur me ankesën e protokolluar me nr. 763/19, dt. 29.10.2019, ka qenë data 18.10.2019, ora 16: 00, kjo për faktin se AK në platformën elektronike E-prokurim, me dt. 08.10.2019, ka marr vendim ku AK i ka dhënë përgjigje OE ankues në kërkesën e tij për rishqyrtim të vendimit të AK-së.

Prandaj paneli shqyrtues vjen në përfundim se operatori ekonomik OE Ntsh "AtomMed"-Ferizaj, e ka lëshuar afatin ligjor për parashtrim të ankesës në OSHP, andaj duke u bazuar nga ky fakt paneli shqyrtues konstaton se ankesa me numër të protokollit 763/19 e dt. 29.10.2019, hedhet si e jashtë afatshme dhe se e njëjta nuk mund të hyn në shqyrtim nga ana e panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Goran MILENKOVIC



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - Spitali Regjional-Prizren

1x1 OE - Ntsh "AtomMed"-Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.